

KËSHILLA PRAKTIKE PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT TË KËRKESËS DREJTUAR GJYKATËS KUSHTETUESE

1. Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese duhet të paraqitet në formë të shkruar në gjuhën shqipe, qartë e kuptueshëm dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 27 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar nenit 27, pika 2, shkronja “d” të këtij ligji. (Preferohet përpilimi i kërkesës në format elektronik *word*). Gjithashtu jeni të lutur t’i qëndroni standardeve zyrtare të kërkuara, lidhur me paraqitjen e kërkesës drejtuar institucionit, si dhe të shmangni gjuhën joetike, fraza apo shprehje të pahijshme në hartimin e kërkesës.
2. Çdo faqe e kërkesës duhet të jetë e numërtuar dhe e firmosur. Nëse kërkesa do të firmoset nga përfaqësuesi, asaj duhet t’i bashkëlidhet kopje origjinale e aktit të përfaqësimit (i përpiluar para noterit nga vetë kërkuesi, për përfaqësimin e tij para Gjykatës Kushtetuese), ose autorizim i lëshuar në prani të drejtuesit të institucionit (nëse kërkuesi është duke vuajtur dënimin në një institucion të vuajtjes së dënimeve penale). Kërkesa e firmosur nga përfaqësuesi me prokurë (ose autorizim) duhet të përmbajë krahas firmës së përfaqësuesit edhe vulën e tij.
3. Kërkesës duhet t’i bashkëlidhen kopje origjinale ose të noterizuara të vendimeve të kundërshtuara, ankimit dhe rekursit. Çdo dokument tjetër, shoqërues i kërkesës, mund të paraqitet dhe në kopje të panoterizuara.
4. Kërkesa dhe materialet bashkëlidhur saj duhet të përgatiten në aq kopje (fotokopje, jo domosdoshmërisht të noterizura) sa janë dhe subjektet e interesuara.
5. Materialet dhe dokumentet e paraqitura bëhen pjesë e dosjes gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe nuk kthehen.
6. Kërkesa mund të dorëzohet dorazi pranë Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit të Gjykatës Kushtetuese ose të postohet në adresën e Gjykatës Kushtetuese: bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.26, Tiranë, Shqipëri.
7. Në vendimet e saj Gjykata Kushtetuese publikon të dhënat personale të kërkuesve (emër, mbiemër) dhe subjekteve të interesuara. Garancia kushtetuese e publicitetit në administrimin e drejtësisë nuk mund të shmanget, përveçse për arsye që kanë së bëjnë me mbrojtjen e të drejtës private dhe familjare. Çdo kërkues, që kërkon ruajtjen e të dhënave të tij personale, krahas kërkesës drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duhet të



paraqesë dhe kërkesë të veçantë për mospublikimin e të dhënave të tij personale në vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Për të garantuar mbrojtjen e të dhënave me karakter personal dhe me qëllim të zhvillimit sa më të drejtë të shqyrtimit kushtetues të çështjes, çdo kërkesë për anonimizimin e të dhënave duhet paraqitur formalisht (e nënshkruar). Kërkesa duhet të shpjegojë qartë pasojat që kërkuesi pretendon se publikimi i të dhënave personale mund t'i sjellë atij, në kuadër të jetës së tij private dhe familjare.

8. Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese duhet t'i përmbahet kritereve të parashikuara në nenin 71/a të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, për ushtrimin e ankimit kushtetues individual.
9. Abuzimi me të drejtën për të paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 100,000 – 500,000 lekë, sipas parashikimeve të nenit 31, shkronja “c”, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar. Nëse Gjykata konstaton se ndodhet përpara rasteve të falsifikimit të dokumenteve ose ndonjë vepre tjetër penale, ajo i dërgon materialet për hetim prokurorisë.
10. Për më shumë informacion në lidhje me llojet e kërkesave drejtuar Gjykatës Kushtetuese, vendimmarrjen e kësaj Gjykate, të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose kolegjeve të saj, mund të shihni/aksesoni faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese www.gjk.gov.al / vendime, rubrikat “Vendime përfundimtare” ose “Vendime të moskalimit të çështjeve në seancë gjyqësore”. Për një kërkim më të detajuar referojuni Indeksit Sistematik po në këtë faqe.

